


Projekti

RISE Balkans synon të fuqizojë pjesëmarrjen e të rinjve në jetën demokratike, transparencën dhe nismat kundër korrupsionit në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Greqi, Bullgari dhe Kroaci. Ky projekt zbatohet nga një konsorcium institucionesh akademike dhe organizatash të shoqërisë civile, me synim fuqizimin e të rinjve të moshës 18–26 vjeç përmes edukimit qytetar, të nxënit përmes përvojës, mentorimit dhe shkëmbimeve rajonale ndërkufitare. Pjesëmarrësit do të angazhohen në nisma praktike, përfshirë simulime të procesit të hartimit të ligjeve, aktivitete kundër korrupsionit dhe dialogu të strukturuar me institucionet, duke kontribuar në legjislacionin dhe reformat e politikave lokale kundër korrupsionit dhe nxitjen e qeverisjes transparente.

Objektivat tona

- Rrisë njohuritë, aftësitë dhe motivimin e të rinjve për pjesëmarrje aktive në proceset demokratike.
- Fuqizojë të rinjtë për të konceptuar, zbatuar dhe mbështetur iniciativa qytetare që promovojnë përgjegjësinë, integritetin, solidaritetin dhe angazhimin qytetar.
- Forcojë bashkëpunimin rajonal dhe advokimin e të rinjve për reforma demokratike.

Kush mund të marrë pjesë


RISE Balkans është projektuar për të rinj të moshës 18–26 vjeç. Studentë, aktivistët e rinj dhe të rinj të interesuar për pjesëmarrjen demokratike, qeverisjen e mirë, transparencën dhe luftën kundër korrupsionit ftohen të marrin pjesë.

Një vështrim i përgjithshëm

15.02.2026 – 14.02.2028

Greqi • Bullgari • Kroaci
Shqipëri • Maqedoni e Veriut

EACEA
CERV-2025
Numri i projektit: 101253022



Ne fuqizojmë të rinjtë për:

Përgjegjësi



Integritet



Solidaritet



Angazhim qytetar



Një zë rinor të fortë



Ekipi

Koordinatori i projektit: Profesori Dimitris Ziouvas (Eurocrim)

European University Center for Crime & Justice (GR)
Partneri kryesor

Centre for Civil Communications (MK)

Miko Tripalo Centre (HR)

University of Zagreb, Faculty of Law (HR)

Partners Albania (AL)


University of National and World Economy (BG)

EURO-EDU (GR)

National Student Confederation (BG)

Financuar nga Bashkimi Evropian

Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë megjithatë vetëm të autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). As Bashkimi Evropian, as EACEA nuk mund të mbahen përgjegjëse për to.



Si funksionon RISE Balkans

RISE Balkans bazohet në një qasje të integruar, që nis me hulumtim dhe ngritjen e kapaciteteve të të rinjve, vijon me nisma të ideuara dhe zbatuara nga të rinjtë dhe dialog me institucionet, dhe finalizohet me shkëmbimin e përvojave në nivel evropian. Përmes aktiviteteve kombëtare dhe rajonale, projekti ndihmon të rinjtë të zgjerojnë njohuritë, të zhvillojnë aftësi praktike, të ideojnë dhe zbatojë nisma konkrete dhe të sjellin idetë e tyre në dialog me institucionet në nivel kombëtar dhe të BE-së.

Aktivitetet ku mund të përfshiheni

Si pjesëmarrës në RISE Balkans, ju mund të përfshiheni në:

- Hulumtim
- Klinikat e Qeverisjes së Mirë
- Laboratorë për Angazhimin Qytetar Rinor
- Diskutime mbi qeverisjen
- Tregim digjital dhe multimedial
- Kampe intensive për të rinjtë
- 5 aktivitete rajonale online
- Takim me institucionet në Bruksel, Belgjikë

Vizitë në Bruksel (2027)



Të rinj përfaqësues nga të gjitha vendet partnere të projektit do të vizitojnë Brukselin, ku do të takohen me politikëbërës të Bashkimit Evropian dhe do të njihen nga afër me institucionet e BE-së.

risebalkans.eu

risebalkans@gmail.com

instagram.com/risebalkans

linkedin.com/in/eurocrim-project-eu/

Na ndiqni

Pika(t) kombëtare të kontaktit

PARTNERSALBANIA FOR CHANGE AND DEVELOPMENT

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

partners@partnersalbania.org

Financuar nga Bashkimi Evropian

Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë megjithatë vetëm të autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). As Bashkimi Evropian, as EACEA nuk mund të mbahen përgjegjëse për to.